

RAPORT TRAJNIMI – 3 KORRIK 2024

Titulli: Vëzhgimi dhe dokumentimi në fëmijërinë e hershme

Data: 3 korrik 2024

Vendi: Qendra Mediale

Trajnere: Violeta Buza

Pjesëmarrës: Studentë të vitit të 3-të dhe 4-t të Shkencave Sociale – AAB College

Qëllimi i trajnimit:

Të aftësojë studentët për të kuptuar dhe aplikuar teknikat e vëzhgimit dhe dokumentimit në procesin edukativ në institucionet e fëmijërisë së hershme, si pjesë e vlerësimit formativ dhe ndërtimit të planeve mësimore të individualizuara.

Përmbajtja e trajnimit:

- Kuptimi i vëzhgimit sistematik dhe qëllimeve të tij
- Llojet dhe teknikat e vëzhgimit
- Dokumentimi: mënyra, mjetet dhe përmbajtja
- Ndërtimi i instrumenteve për vëzhgim dhe planifikim të personalizuar
- Diskutim mbi rolin e dokumentimit në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies

Rezultatet:

Studentët fituan njohuri praktike mbi mënyrat efektive të mbledhjes së informacionit mbi zhvillimin e fëmijës dhe u angazhuan në ushtrime të aplikueshme në praktikë.